

V E N D I M
Nr.73, datë 11.2.1999

PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Punëdhënësit, që angazhojnë për qëllim formimin nëpërmjet punës të personave punëkërkues të papunë, mund të përfitojnë financime nga zyra kompetente e punësimit, me kusht që në përfundim të periudhës së formimit të punësojnë, me kontratë të rregullt, me kohëzgjatje të paktën një vjeçare, në pjesë të të trajnuarve. Pjesëmarrësit në formim duhet të jenë persona profesionalisht të pakualifikuar për proceset e punës, për të cilat do të formohen.

Kohëzgjatja e programit mund të jetë deri në 9 muaj. Financimi përfshin kompensimin e kostove për sigurime të detyrueshme deri në masën 100 për qind. Kompensimi i pagës bëhet deri në masën e pagës minimale në shkallë vendi. Numri i personave që punësohen të jetë të paktën 40 për qind e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në formim.

2. Për çdo të punësuar mbi numrin e fiksuar në marrëveshje, punëdhënësi merr një shpërblim të barabartë me shumën e pagës minimale në shkallë vendi dhe shpenzimet për sigurimet e detyrueshme për një periudhë deri 3-mujore.

3. Personat punëkërkues të papunë, që kundërshtojnë ofertën e zyrës kompetente të punësimit, për pjesëmarrjen në formim, si më sipër, hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë.

4. Fondet e programit të pagesës së papunësisë, të kursyer nga zbatimi i këtij programi, transferohen, në masën 100 për qind, në buxhetin e këtij programi.

5. Për çdo person të trajtuar nga ky program, që është pjesëtar i një familjeje në ndihmë ekonomike, buxheti i këtij programi përfiton transferime nga buxheti i ndihmës ekonomike në masën 40 për qind të ndihmës së plotë për një familje me 4 persona, për çdo muaj trajtim.

6. Ngarkohet Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij programi.

Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të përcaktojë kriteret e detajuara dhe të mbikëqyrë zbatimin e këtij programi dhe të këtij vendimi.

7. Kostoja e këtij programi mbulohet nga fonde të buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko